

## **Instituti “Kyriaz” nga gur themeli i arsimit kombëtar shqiptar në tempull i trashëgimisë kulturore e historike, që ka nevojë për mbrojtje e konservim**

**Dr. Edlir ORHANI, Drejtorja e Mbështetjes Shkencore & Edukimit Qytetar, AIDSSH  
Lektor nderi pranë Kolegjit Universitar “Qiriazi”, Tiranë  
edlir.orhani@yahoo.com**

### **Abstrakt**

Kolegji Universitar “Qiriazi” e ka zanafillën që në vitin 1922, kur Parashqevi Qiriazi (1887–1971), Sevasti Qiriazi (1871–1949) dhe Kristo Dako (1876–1941) themeluan Institutin Femëror “Kyrias” në Kodër-Kamëz. Ky institut u krijua me synimin për të promovuar emancipimin e gruas, arsimimin, barazinë gjinore dhe fuqizimin e pozitës së gruas shqiptare në jetën shoqërore dhe politike. Ai përfaqësonte një vazhdimësi të traditës familjare të Qiriazëve dhe u mbështet në përvojat jetësore të tyre në Rumani, Turqi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe në angazhimin aktiv të motrave Qiriazi në çështjet kombëtare shqiptare. Edhe në ditët e sotme, ky institucion mbetet unik dhe i pakrahasueshëm – jo vetëm për trashëgiminë e pasur historike që mbart, por edhe për arkitekturën e veçantë, e cila frymëzon çdo veprimtari edukative, shkencore apo shoqërore. Për këtë arsye, meriton vëmendje të veçantë si nga studiuesit, ashtu edhe nga institucionet shtetërore, në veçanti nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Metodologjia e përdorur në këtë studim është cilësore dhe eksploruese, e përqendruar në studimin e dokumenteve arkivore, analizën e fotografive dhe skicave arkitektonike, si dhe intervistimin e pasardhësve të familjes Dako. Këto metoda kanë çuar në gjetje me vlerë dhe në dhënie të rekomandimeve konkrete lidhur me statusin kulturor dhe ligjor të institucionit. Qëllimi final i këtij studimi është të mbështesë hapat paraprakë drejt shpalljes së Kolegjit Universitar “Qiriazi” - pasardhës i Institutit Femëror “Kyrias” - si monument kulture ose objekt me vlerë historike.

*Fjalë çelës: gur themeli, arsim kombëtar, veti arkitektonike, objekt kulturor*

### **THE “KYRIAZ” INSTITUTE - FROM BEING THE CORNERSTONE OF ALBANIAN NATIONAL EDUCATION TO A TEMPLE OF HISTORICAL HISTORY - IN NEED OF CONSERVATION PROTECTION**

#### **Abstract**

Kolegji Universitar “Qiriazi” traces its origins back to 1922, when Parashqevi Qiriazi (1887-1971), Sevasti Qiriazi (1871-1949), and Kristo Dako (1876-1941) founded the Kyrias Female Institute (Institutit Femëror “Kyrias”) in Kodër-Kamëz. This institution was established with the aim of promoting women’s emancipation, education, gender equality, and the empowerment of Albanian women in both social and political spheres. It represented a continuation of the Qiriazi family tradition and drew upon their lived experiences in Romania, Turkey, and the United States, as well as the sisters’ active involvement in addressing Albanian national issues. Even today, the institution remains unique and

incomparable - not only for its rich historical legacy but also for its exceptional architecture, which continues to inspire educational, scientific, and social activities. For these reasons, it deserves special attention from both scholars and public institutions, particularly the Institute of Cultural Monuments (Instituti i Monumenteve të Kulturës). The methodology employed in this study is qualitative and exploratory, focusing on the examination of archival documents, analysis of historical photographs and architectural sketches, and interviews with descendants of the Dako family. These methods have led to meaningful findings and the development of practical recommendations regarding the legal and cultural status of the institution. The ultimate goal of this study is to support the preliminary steps toward the official designation of Kolegji Universitar "Qiriazi" - the successor of the Kyrias Female Institute - as a cultural monument or historical heritage site.

**Keywords:** *cornerstone, national education, architectural feature, cultural object*

## Hyrje

Kolegji Universitar "Qiriazi" është pasardhës i Institutit Femëror "Kyriaz", i themeluar në Kodër-Kamëz në vitin 1922 dhe i rihapur mbi bazën e "Shkollës së Vashave" në Korçë më 1891. Sot për sot është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Shqipëri që ka historinë e vazhdimësisë, 131 vite nga themelimi në Korçë dhe 100 vite nga rihapja në Tiranë. Themeluesit e këtij institucioni janë Sevasti e Parashqevi Qiriazi dhe Kristo Dako, patriotë, rilindës dhe ikona të arsimit tonë kombëtar. Hapja e këtij institucioni arsimor me statusin e "Kolegjit të Lartë Universitar" u realizua në vitin 2006 nga Robert Dako, për t'u ri çelur me standardet e *Ligjit të ri për arsimin e lartë* nga Prof. Dr. Gjakë Ulledaj, në vitin 2016. Rrugëtimi i këtij Institucioni të Arsimit të Lartë është sa i bukur dhe mbresëlënës, sa i vështirë dhe frymëzues, sa tragjik dhe interesant. Jo më kot gazetari dhe pedagogu i nderuar, Dr. Gjovalin Gjeloşi do t'i kushtonte një libër të titulluar "Mosha e Artë e një Universiteti". Vlen të citohet shprehja e tij:

*nëse për një njeri mosha e artë do konsiderohet 20-25 vjeçare, universiteti e arrin këtë pasi ka mbyllur shekullin dhe Instituti Femëror "Kyriaz" sot Kolegji Universitar "Qiriazi" e ka këtë fat. (Gjeloşi, 2023).*

## Objektiva

- Të vlerësojë profesionalisht sfondin historik të Institutit "Kyriaz" sot Kolegji Universitar "Qiriazi";
- Të nxjerrë në pah e vlerat edukative, historike dhe arkitektonike të këtij institucioni;
- Të japë argumente bindëse pse duhet trajtuar si objekt historik dhe monument kulturor.

## Kufizimet dhe limitet e studimit

Pavarësisht nga rezultatet, ky studim ka në vetvete edhe disa kufizime që duhet të adresohen në kërkimet e ardhshme. *Së pari*, ky studim nuk është një studim thjesht gjatësor, pasi ai synon të futet në brendësi të problemit që trajton. *Së dyti*, studimi nuk u përqendrua në konsulta me punonjës të institutit të monumenteve, por në bazë të mendimit tim personal si specialist i trashëgimisë kulturore.

## Çështje etike

Në këtë studim nuk ka pjesë të kopjuara dhe në çdo rast është cituar emri i autorit. Si burim bazë është marrë libri "Mosha e Artë e një Universiteti", të autorit Gjovalin Gjeloşi dhe si materiale dytësore dokumentet arkivore apo ato elektronike.

### **Instituti "Kyriaz" si gur themeli i arsimit kombëtar shqiptar**

Historia e gur themelit të këtij institucioni nis me Gjerasim Qiriazin, i cili ishte i pari që hodhi idenë e çeljes së një shkollë shqipe kushtuar femrave. Kjo shkollë do të çelej në tetor të vitit 1891 dhe do t'i hapte dyert pikërisht në shtëpinë e familjes Qiriaz. Njëra prej dhomave të kësaj shtëpie do të merrte pamjen e një klase të mirëfilltë, ku do të vendoseshin disa banka me madhësi të ndryshme, një tavolinë për mësuesen, një dërrasë e zezë dhe disa harta të varura mureve. Shkolla e vashave ose ndryshe Instituti "Qiriaz", do të fitonte shumë shpejt një popullaritet të madh dhe kjo do të ndikonte dukshëm edhe në rritjen e numrit të nxënësve, nga tre vajza të regjistruara në fillim të vitit shkollor, në mbyllje të tij numri arriti në 27.

### ***Çfarë e veçon Institutin "Qiriaz" nga shkollat e tjera të kohës?***

Shkolla e vashave nuk ishte thjesht një institucion laik ku zhvillohej mësim në gjuhën amtare, por ishte një pararendëse e arsimit të lartë shqiptar, pasi ishte ngritur dhe funksiononte mbi baza të mirëfillta shkencore dhe mbi koncepte të mirëfillta pedagogjike. Vetë programi lëndor i saj e vërteton një gjë të tillë: në shkollë mësoheshin lëndë si gjuha shqipe (shkronjëtorja), alfabeti (këndimi), të shkruarit (bukurshkrimi), trup-tregonja e njeriut (anatomia), botëshkronja (histori e botës) dhe shkronja (gjeografia), kafshëshkronja, (zoologjia), bimëshkronja (biologjia), histori e shenjtëruar (histori e feve), këndimi i ungjillit (fjalëlidhja), punëdore (qepje, qëndisje, thurje me shtiza), vjersha, këngë, valle, dialogë), aritmetika, gjeometria. Në programet arsimore një vend të rëndësishëm zinte edhe mësimi i gjuhëve të huaja, si latinisht, greqishte e vjetër e arabisht, sikundër edhe gjuhë moderne si anglisht, frëngjisht e italisht. Pra, vajzat merrnin që në embrion një edukim pedagogjik dhe parapërgatiteshin për të qenë edukatore të së ardhmes. Duhet theksuar se shumica e teksteve bazë u hartuan nga mësuesit e shkollës, çka tregon se ata kishin një përgatitje të lartë shkencore dhe profesionale.

Instituti "Kyriaz" hapet më 2 tetor 1922; më 11 prill 1925 vendoset guri i themelit në godinën e re në Kodër - Kamëz. Gradualisht, në vitin shkollor 1930-1931 ky Institut merr formën e mirëfilltë të një shkolle të lartë, pasi organizohet në dy departamente: Departamenti Gjymnazial, në të cilin nxënëset që kishin mbaruar shkollën fillore merrnin mësim të përgjithshme dhe Departamenti Superior, i cili ndahej në tri degë të specializuara: Dega e Shkencave apo Dega e Ekonomisë Shtëpiake, Dega e Shkencave Pedagogjike dhe Dega Liceale (klasike). Mësimet jepeshin sipas një programi të aprovuar nga shteti. Përveç arsimit të vajzave të reja, drejtuesit e Institutit planifikuan që të jepnin mësim të veçanta për gratë e martuara. Për këtë arsye, u hap departamenti i shkencave shtëpiake dhe një departament i ekonomisë shtëpiake. Edukimi i grave të martuara nëpërmjet këtyre departamenteve ndikoi shumë në rritjen e nivelit të kulturës së jetesës në familjet shqiptare, pjesë e të cilave ishin këto gra. Kultura dhe mësimet që morën në Institutin "Kyriaz" ndikuan dukshëm në përmirësimin e nivelit të jetesës dhe në edukimin e fëmijëve të tyre.

Në programet e vitit 1931 e në vijim, drejtuesit e Institutit thurnin plane të reja, të cilat do ta çonin këtë institucion në shtigje të pashkelura më parë, por me besim të plotë se do të arrinin në parametra të arsimit perëndimor. Qëllimi i tyre ishte që në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Instituti të riorganizohet në një sistem 4 vjeçar gjymnazial të ulët dhe 4 vjeçar liceal superior. Gjithashtu, edhe Dega Normale të bëhej 8 vjeçare. Si plotësuese për Degën Normale, të çelej një shkollë fillore, që të vlente jo vetëm për praktikën e normalistëve, por edhe të përgatiste vajza të vogla me njohuri të shëndosha. Gjithashtu, ishte menduar të çelej edhe një foshnjore e sistemit "Montesori" për fëmijë të

vegjël të moshës 4-6 vjeçare, transporti i të cilëve do të sigurohej me autobus - në mëngjes dhe në mbrëmje.

Instituti “Kyriaz”, veç të tjerash, kishte rregulla të ngjashme me shkollat e vendeve të përparuara për sa i përket marrjes në punë të mësuesve. Nga që mungonin mësueset brenda vendit, drejtoria e Institutit hynte në kontakt me mësuese të huaja, si italiane, amerikane, austriake, franceze e të tjera, të cilat, pasi njiheshin me kushtet e kontratës, fillonin punë në këtë Institut. Mësueset ishin rezidente dhe si shtëpi banimi shërbente kati dytë i një ndërtese të bukur që funksionon edhe sot. Drejtoria e Institutit bënte një punë mjaft të kujdesshme me personelin, jo vetëm për rekrutimin e tyre si pjesëtarë të trupës pedagogjike-mësimore, por edhe në trajtimin e tyre në vijimësi.

Bëmë këtë rezume për të nxjerrë në pah vlerat e padiskutueshme të kësaj shkolle, e cila, për kohën kur u ngrit dhe funksionoi, ishte e pakrahasueshme me ndonjë tjetër. Kjo, jo vetëm se ishte një institucion arsimor, i cili dha kontribut në të gjitha nivelet e arsimit dhe i parapriu arsimit universitar, por sepse ishte edhe një fole e çështjes kombëtare shqiptare. Historia e kësaj shkolle përfaqëson historinë e arsimit tonë kombëtar dhe vlerësimi i saj, nga ana tjetër, është homazh për të gjitha shkollat e ngjashme me të, të cilat përhumbën nën rrjedhën e historisë dhe nuk patën fatin të trajtohen si objekte apo monumente të saj.

Sipas Dr. Gjovalin Gjeloši (2023):

*në themelet e arsimit të lartë nuk qe guri i vetëm ky i Qiriazëve, qenë edhe gurë të tjerë, por në lartësimin e mureve të kësaj ngrehine vetëm ky gur mbeti. Ishte një gur faqok. Por ky gur faqok ka nevojë për kujdes dhe vëmendje që të mos pësojë fatin tragjik të të tjerëve.*

#### Sfondi historik i godinës së Institutit Kyriaz sot Kolegji Universitar “Qiriaz”

Viti 1891	Hapet në Korçë Shkolla Vashave, nga Gjerasim dhe Sevasti Qiriaz.
Viti 1922	Hapet në Tiranë Instituti “Kyriaz”, nga Kristo Dako, Sevasti Qiriaz dhe Parashqevi Qiriaz.
Viti 1945	Godina shtetëzohet dhe funksionon si shkollë ushtarake dhe e përgatitjes së kuadrove komunistë.
Viti 1949	Shërben si teknikumi shtetëror i Bujqësisë.
Viti 1956	Godina e Institutit “Kyriaz” kthehet në Korpusin Qendror të Universitetit të Lartë Bujqësor (sot UBT). Më pas, si Fakultet i Inxhinierisë Pyjore.
Viti 1992	Godina u kthehet trashëgimtarëve të ligjshëm të familjes Dako- Qiriaz.
Viti 2006	Themelohet nga Robert Dako Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Sevasti dhe Parashqevi Qiriaz”.
Viti 2016	Rihapet me të drejta të plota në të njëjtën godinë nga Prof. Dr. Gjokë Ulledaj Kolegji Universitar “Qiriaz”.

Siç e shohim edhe në tabelë, godina e Institutit femëror “Kyriaz”, pësoi shumë goditje gjatë vendosjes së regjimit totalitar, duke u shtetëzuar dhe humbur identitetin, emrin dhe qëllimin për të cilin ishte themeluar. Por, pavarësisht kësaj, trashëgimtarët ia rikthyen sërish identitetin e mohuar, duke i kërkuar edhe pronarit të fundit të saj, që t’i ruajë të njëjtin identitet dhe të njëjtin emër. Në këtë mënyrë, kanë mbajtur gjallë trashëgiminë historiko-kulturore të ngritur me aq dashuri nga Kristo Dako dhe Sevasti e Parashqevi Qiriaz.

## Të dhëna

Duke u bazuar në analizën e të dokumenteve dhe fakteve që kemi mundur të sigurojmë, në mënyrë të përmbledhur mund të shkruhet:

Instituti femëror "Kyriaz", sot Kolegji Universitar "Qiriazi" përfaqëson një ndër institucionet e para arsimore në historinë e zhvillimit të arsimit tonë kombëtar, pasi është i vetmi institucion i arsimit të lartë në Shqipëri, që ka historinë e vazhdimësisë (131 vite nga themelimi në Korçë dhe 100 vite nga rihapja në Tiranë).

Në vitin 1922 Instituti Femëror "Qiriazi" u hap fillimisht në një shtëpi tiranase - atë të S. Kusit - në të ashtuquajturën "*Rruga e Fiqve*". Viti shkollor 1927-1928 filloi në godinën e re, aty ku është edhe sot Kolegji Universitar "Qiriazi".

Instituti femëror "Kyriaz", sot Kolegji Universitar "Qiriazi", nxori shumë edukatore femra që luajtën një rol të rëndësishëm në histori, pasi kontribuuan jo vetëm në fushën e arsimit, por u bënë edhe luftëtare të njohura të çështjes kombëtare. Jo më kot ky Institut, është cilësuar edhe si "fole kombëtare". Ndër emrat më të spikatur ishin Musine Kokalari e Drita Kosturi. Instituti femëror "Kyriaz", sot Kolegji Universitar "Qiriazi", është simbol i rezistencës, pasi mbijetoi dhe funksionoi në kushte mjaft të vështira, duke u përballur me varfërinë, paragjykimet ndaj arsimit të femrave, kundërshtimin politik nga autoritetet lokale osmane dhe opozitën politike apo atë kishtarë të Kishës Ortodokse Greke. Sipas Edit' h Durham, është e vetmja shkollë në gjithë Shqipërinë e Jugut, ku fëmijët shqiptarë lejoheshin të mësonin shkrim e këndim në gjuhën e tyre amtare, e cila qëndronte e hapur duke u përballur me të gjitha kërcënimet. Kjo shkollë ishte gjithmonë plot me nxënës, ndonëse po ta vazhdoje atë, do të thoshte të përndiqeshe nga turqit ose të shkishëroheshe nga prifti grek.

Ky Institut, ndryshe nga shumë shkolla të tjera, ka luajtur edhe një rol shumë të rëndësishëm në aspektin social, pasi u ngrit për të nxitur emancipimin, arsimimin, barazinë gjinore, të drejtat si individ, fuqizimin e statusit dhe rolit shoqëror e politik të gruas shqiptare. Jo më kot thuhet se vajzat, që e ndoqën atë, hoqën mbulesën dhe përqaftuan librin.

Rilindës, shkrimtarë e publicistë shqiptarë dhe të huaj e kanë vlerësuar këtë shkollë si arritja më e madhe e Rilindjes dhe e kanë emërtuar: "*Fole Kombëtare*" apo "*Fanar ndriçues i Shqipërisë*", "*Ndera e Mbretërisë*", "*Rubin e diamant*", "*Tempull i shenjtë*", "*Altar kombëtar i shqiptarizms*", "*Far i bregdetit*"; një shkollë e formës amerikane, "*Fidanishte mësuesesh*" etj.

Instituti femëror "Kyriaz", sot Kolegji Universitar "Qiriazi" ka pësuar dy goditje radhazi, por pavarësisht kësaj, ka arritur të ruajë fizionominë origjinale të tij. Goditjen e parë e mori në 1933, kur qeveria e Zogut nxori vendimin për mbylljen e saj nën justifikimin e ndërtimit të një sistemi arsimor kombëtar, përmirësimin e programeve arsimore, riorganizimin e arsimit për gruan shqiptare dhe hapjen e shkollave të reja. Ligji i Ministrisë së Arsimit i hartuar në vitin 1928 parashikonte ndërmarrjen e një reforme dhe kryerjen e ndryshimeve në programet shkollore, arsimin profesional dhe sistemin arsimor shkollor fillor dhe të mesëm. Vendimi parashikonte mbylljen e shkollave private e fetare. Në Prill 1933, Parlamenti e shpalli arsimin e shtetasve shqiptarë si të drejtë ekskluzive e shtetit, të detyrueshëm dhe falas. Ndonëse ligji lejonte veprimtarinë e institucioneve private, nëse këto bashkëpunonin me shtetin, këtij Instituti nuk iu dha mundësia të vazhdonte punën e tij, por u mbyll.

Goditjen e dytë, Institutit Femëror "Kyriaz" e mori pas vendosjes në 1945 të regjimit totalitar, pasi në vitin 1944 u mbyll për të mos u çelur më për 60 vjet. Ky lloj qëndrimi buronte si nga kontributi që njëri nga themeluesit kryesorë të tij, Kristo Dako, kishte dhënë në qeverinë e Ahmet Zogut, ashtu edhe nga tendencat pro amerikane të motrave Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi.

Programet e studimit janë cilësuar si themele të arsimit të lartë dhe pararendëse të tij. Provimet ktheheshin në festë "kombëtare". Shumë gazeta të kohës në lajmet informative përcillnin "*emocione dhe festë*" në provime. Dhe kjo atmosferë përcillej si nga shkolla e vashave në Korçë, ashtu edhe prej Institutit "Kyriaz" në Tiranë.

Mësuesi në Institutin "Kyriaz" shihej si ikonë. Instituti "Qiriazi", qysh në themelim si shkollë vajzash në Korçë, pati mësues të aftë e të përkushtuar dhe që ishin tepër frymëzues për edukueset e ardhshme. Kjo për vetë faktin se këta mësues ishin vërtetë figura emblematike me kulturë perëndimore dhe kishin luajtur një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare.

Instituti Femëror "Kyriaz", pavarësisht mbylljes për një afat të gjatë, kaloi në një epokë të re pas rënies së regjimit totalitar. Kjo epokë i dha një tjetër status, si fillim atë të shkollës së lartë në vitin 2006 dhe atë të Kolegjit Universitar në vitin 2016, ku emri Qiriazi, mbeti marka kryesore.

Pronarët e Kolegjit Universitar "Qiriazi" kanë vazhduar të njëjtën rrugë si pasardhësit e familjes, me qëllimin e vetëm ruajtjen e trashëgimisë. Ky qëllim i mirë është shfaqur në aktivitete të ndryshme dedikuar veprimtarisë së motrave Qiriazi dhe Kristo Dakos, në kremtimin e 100 vjetorit të Institutit Femëror "Kyriaz" sot Kolegji Universitar "Qiriazi", në organizimin e simpoziumit të artë dedikuar ikonave të arsimit shqiptar apo figurave emblematike të familjes Qiriazi dhe në dokumentarin "Përvjetori i Artë".

Charles R. Crane, miku personal i Kristo Dakos, industrialist dhe këshilltar i presidentit amerikan Woodrow Willson, ka dhënë një përkrahje të madhe financiare si për themelimin e shkollës së vashave në Korçë ashtu dhe në themelimin e Institutit "Kyriaz", në Kodër –Kamëz. Ai është simbol i solidaritetit e humanizmit dhe pjesë e historisë së kolegjit Universitar Qiriazi. Salla qendrore e konferencave mban me krenari emrin dhe pllakadën e tij. Në këtë mënyrë është vepruar edhe për ri jetësimin e figurës së eruditit dhe patriotit Kristo Dako, duke i dhënë kabinetit mësimor të Hoteleri Turizmit, emrin e tij.

### **Instituti "Kyriaz" si tempull i trashëgimisë kulturore e historike, i cili ka nevojë për mbrojtje e konservim**

Instituti "Kyriaz" - sot Kolegji Universitar "Qiriazi" - është një vepër e rrallë, e cila ka nevojë për mbrojtje dhe konservim. Në këndvështrimin e një profesionisti mund të cilësohet edhe si Monument Kulturor edhe si Objekt Historik. Vlerën e monumentit kulturor ia jep arkitektura e tij, e cila ka një ndërthurje të artit barok me atë klasik, ku bukuria dhe funksionalitetit shkrihen me njëri tjetrin. Vlerën e objektit historik ia jep sfondi i pasur historik mbi të cilin ka rrugëtuar, roli që ka luajtur në historinë e arsimit shqiptar dhe figurat emblematike, të cilat e themeluan. Por ky tempull është lënë në harresë nga ana e institucioneve shtetërore, ca nga padituria e ca nga mungesa e vullnetit për t'i dhënë vendin që i takon. Meritë për mbijetesën e tij kanë vetëm pasardhësit e familjes, të cilët, pas shumë vështirësish, arritën ta rihapnin në vitin 2006, duke çuar në vend amanetin e gjyshërve dhe të stërgjyshërve. Robert Dako e ruajti trashëgiminë e të parëve si në arkitekturë, ashtu edhe në mision, pasi për të të dyja kishin rëndësi për ta mbajtur të gjallë kujtimin e Gjasasimit, Kristos, Sevastisë, Parashqevisë dhe veprave që ata lanë. Nën emërtimin Shkolla e Lartë "*Parashqevi dhe Sevasti Qiriazi*" dhe në të njëjtën ndërtesë të bukur, ku u çel dhe funksionoi dikur Instituti femëror "Kyriaz", Dako rihapi dyert për të edukuar brezat e rinj, ashtu siç kishin bërë të parët e tij. Merita i takon edhe Prof. Dr. Gjokë Ulledaj, i cili duke ecur në të njëjtën rrugë, respektoi si trashëgiminë arkitekturore dhe mbiemrin e emblemave të arsimit shqiptar, duke e rihapur këtë shkollë nën emërtimin Kolegji Universitar "*Qiriazi*" në vitin 2016. Robert Dako dhe Gjokë Ulledaj, edhe pse nuk kanë qenë në rolin e specialistit të monumenteve, kanë dhënë një kontribut

të vyer në ruajtjen e kësaj vepre historiko-kulturore, pasi kanë parandaluar shkatërrimin, prishjen apo degradimin e saj dhe nuk kanë lejuar që në këtë ndërtesë të ushtrohet asnjë tjetër veprimtari përveç asaj edukative. Ligji nr. 9048, datë 04.07.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore" monumentin e kulturës e përshkruan si një objekt apo ndërtesë me vlerë historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Më konkretisht, monumenti i kulturës është një ndërtim ose vepër me vlerë kulturore, historike dhe artistike, e ndërtuar në një hapësirë të dukshme, ose e ngritur në kujtim të ngjarjeve të rëndësishme, ose të njerëzve të shquar. Zakonisht, ato vihen nën mbrojtjen e shtetit, pasi janë dëshmi e historisë së zhvillimit njerëzor për ruajtjen e së cilës ekziston një interes publik. Kriteret që plotëson Instituti "Kyriaz" sot Kolegji Universitar "Qiriazi" për t'u shpallur Monument Kulture ose si Objekt historik, janë të shumta. Ne po mundohemi të rendisim ato më kryesorët:

1. Së pari, ndërtesa mbi të cilën ushtron veprimtarinë sot kolegji Universitar "Qiriazi" është e njëjta ndërtesë, ku ushtroi veprimtarinë e tij Instituti Femëror "Kyriaz" ose shkolla e vashave. Kjo vazhdimësi i jep me të drejtë statusin e një objektit historik.
2. Së dyti, arkitektura barok dhe ajo klasike kanë qenë të vlerësuar në mbarë botën, si për bukurinë e tyre, ashtu edhe për funksionalitetin që kanë pasur. Ambiente të plota, salla të bollshme, me tavane të larta e me dritare të mëdha plotë dritë, që sjellin mjaft lehtësira në zhvillimin e procesit mësimor. Ruajtja e kësaj arkitekture i hap rrugën vlerësimit si monument kulturor.
3. Së treti, themeluesit e kësaj shkolle kanë qenë të gjithë figura historike me kontribut të madh në lëvizjen kombëtare.
4. Së katërti, në ambientet e shkollës ka shumë objekte historike, si fotografi të vjetra dhe orendi të ndryshme. Këto objekte rrëfejnë shumë rreth kësaj shkolle apo veprimtarisë patriotike të Kristo Dakos (për më shumë rreth figurës së Kristo Dakos, shih Nathanaili, 2016: 68-69), Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit.
5. Së pesti, mbiemri "Qiriazi" i ka mbijetuar kohës, duke e kthyer vetë universitetin në markë. Kjo lidhet edhe me faktin se Qiriazët ishin simbol i dijes, patriotizmit dhe përhapës të dritës në errësirë. Në botën perëndimore institucione arsimore, që lidhen me emra të këtyre përmasave, trajtohen me dashuri dhe konservohen me fanatizëm.
6. Së gjashti, nipi dhe stërmbesat e Kristo Dakos dhe Sevasti Qiriazit jetojnë atje ku jetuan të parët e tyre, vetëm pak hapa larg shkollës. Trashëgimia materiale dhe shpirtërore, që ata mbartin prej të parëve, kanë një peshë të madhe për trajtimin e këtij Institucioni si objekt historik.
7. Së shtati, ekspozita dokumentare e realizuar me profesionalizëm nga duart e specialistëve të Arkivit Qendror të Shtetit dhe e vendosur në muret e Kolegjit Universitar "Qiriazi" dëshmon shumë për vlerat historiko-kulturore që ky institucion mbart.

### **Konkluzionet e studimit**

Siç u përmend edhe pak më sipër, për realizmin e këtij studimi na është dashur të analizojmë dokumente, libra dhe të bëjmë edhe reflektime personale. Për rrjedhojë, hulumtimet dhe reflektimet e kryera gjatë zhvillimit të këtij studimi teorik na kanë çuar edhe drejt disa konkluzioneve me vlerë:

Kolegji Universitar "Qiriazi" është një pasardhës i denjë i Institutit Femëror "Kyriaz", pasi ka ruajtur pasurinë historike të trashëguar prej tij. Sfondi i pasur historik mbi të cilin ka rrugëtuar, roli që ka luajtur në historinë e arsimit shqiptar dhe figurat emblematike, të cilët e themeluan, i japin vlerën e objektit historik.

Trashëgimia e Instituti Femëror “Kyriaz” mishërohet edhe në arkitekturën e Kolegjit Universitar “Qiriazi”, e cila, pavarësisht ndryshimeve sipërfaqësore që ka pësuar, ruan të njëjtën fizionomi. Ndërthurje e artit barok me atë klasik, ku bukuria dhe funksionalitetit shkrihen me njëri tjetrin, i japin vlerën e monumentit kulturor.

Kolegji Universitar “Qiriazi”, si pasardhës i Institutit Femëror “Kyriaz” është një vepër e rrallë historike dhe kulturore, e cila ka nevojë për mbrojtje dhe konservim, për të mos humbur identitetin e tij.

Robert Dako dhe Gjokë Uldedaj kanë bërë një punë të vyer, duke bashkëpunuar për të mbajtur gjallë trashëgiminë dhe traditën e Institutit Femëror “Kyriaz” sot Kolegji Universitar “Qiriazi”. Si rrjedhojë, Prof. Dr. Gjokë Uldedaj u nominua nga Liberale.al si Njeriu i Vitit 2022, me motivin “Për riaktivizimin e kolegjit më të vjetër shqiptar, Instituti “Kyriazi”.

### Sugjerime dhe Rekomandime

Duke shpresuar që përmes këtij punimi dhe dhënies së disa sugjerimeve modeste të kontribuojmë sa mundemi, që ky institucion të trajtohet si monument kulture apo si objekt historik, sepse:

1. *Së pari*, nuk duhet të lejohet që Kolegji Universitar “Qiriazi”, si pasardhës i Institutit Femëror “Kyriaz”, të humbasi Identitetin e tij. Vlerësimi si *monument kulture* nga ana e Institutit të Monumenteve do të ishte një nisëm shumë e mirë për të parandaluar një fenomen të tillë.
2. *Së dyti*, deri më sot janë realizuar disa ekspozita arkivore dhe fotografike, me iniciativa private apo me mbështetjen e Arkivës Qendrore të Shtetit. Por, duhet theksuar se nevojitet më tepër përkrahje nga ana e Institucioneve shtetërore për hapjen e një muzeu të mirëfilltë në ambientet e shkollës, dedikuar veprimtarisë së Institutit “Kyriaz” dhe themeluesve të tij.
3. *Së treti*, nevojitet një restaurim profesional i kësaj ndërtese, veçanërisht në fasada dhe pjesë origjinale, të cilat nuk janë hequr, si dyer druri dhe dritare, me qëllim që të mos lejohet degradimi i tyre dhe të dalin në pah vlerat monumentale.
4. *Së katërti*, brezi i ri duhet informuar më tepër si rreth rolit të Institutit Femëror “Kyriaz” në arsimin Shqiptar, ashtu edhe rreth rolit historik të motrave Qiriazi apo patriotit Kristo Dako. Kjo do ishte një iniciativë shumë e mirë për t’i rehabilituar si figura dhe për t’i pastruar nga pikëpamjet e historisë moniste.

### REFERENCA

- Gjeloshi, G. (2021). *Mosha e artë e një universiteti*. Pegasus.
- Kolegji Universitar “Qiriazi”. (2024). *Kolegji Universitar Qiriazi*. Retrieved January 17, 2024, from <https://qiriazi.edu.al>
- Nathanaili, V. (2016). *Rruga e mundimshme e shkollës shqipe: Çështje, politika & veprimtari në fushën e arsimit, 1912–1944* [The arduous path of Albanian school: Issues, policies & activities in the field of education, 1912–1944]. UET Press.
- Republic of Albania. (2018). *Ligji Nr. 27/2018, Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë* [Law No. 27/2018 on cultural heritage and museums].
- Revista periodike “Kyriaz”. (2023). *Kyriaz* (Issue 1). Kolegji Universitar “Qiriazi”. Retrieved January 17, 2024.
- Sinani, A. (2024, 6 qershor). Kongresi i Manastirit – 116 vite nga alfabeti që na bashkoi: Dokumente arkivore, artikuj dhe fotografi. *Monografi Akademike Shqiptare*.